

Shpërdorimet në Prokurimin Publik

Analizë për Shpërdorimin e Autoritetit Publik në fushën e
prokurimit publik

Shpërdorimet në Prokurimin Publik

Analizë për Shpërdorimin e Autoritetit Publik në fushën e prokurimit publik

Programi për Qeverisje të Mirë, financohet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

Ky botim është realizuar me përkrahjen nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) - i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)". Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Lëvizjes FOL dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së apo KCSF-së.

Projekti "Mbështetja e politikave kundër-korrupsion duke forcuar mbikëqyrjen publike ndaj shërbimeve publike" financohet nga:



CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS

Publikimi i këtij Raporti është përkrahur nga OSI/CRD. Qëndrimet e shprehura në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e OSI/CRD.

Përmbajtja:

I. Hyrje	3
1.1. Përmbledhje Ekzekutive	3
1.2. Qëllimi i Analizës dhe Metodologjia	4
II. Shkeljet me natyrë korruptive gjatë procedurave të prokurimit publik	5
III. Organet rregullative dhe ekzekutive në fushën e prokurimit publik	9
3.1. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	9
3.2. Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik	12
3.3. Agjencia Qendrore e Prokurimit Publik	16
3.4. Koordinimi ndërinstytucional	17
IV. Organet kompetente për luftimin e korrupsionit në procedurat e prokurimit	17
4.1. Prokuroria e shtetit	17
4.4. Agjencia Kundër Korrupsionit	18
V. Konkluzione dhe Rekomandime	20
Falënderime	24
Rreth Lëvizjes FOL	24

Lista e Akronimeve/Shkurtesave

AK- Autoriteti Kontraktues

AKK- Agjencia Kundër Korrupsion

APP- Agjencia e Prokurimit Publik

AQP- Agjencia Qendrore e Prokurimit

EULEX- Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit

IKAP- Instituti Kosovar për Administratë Publike

KPK- Kodi Penal i Kosovës

KRPP- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

LPP- Ligji për Prokurimin Publik

MF- Ministria e Financave

OE- Operatori Ekonomik

OSHP- Organi Shqyrtues i Prokurimit

I. Hyrje

1.1. Përmbledhje Ekzekutive

Shpërdorimi me autoritetin publik në fushën e prokurimit publik është problem që evidentohet tashmë në secilin raport qoftë vendor apo ndërkombëtar. Në shumicën e rasteve përveç shkeljeve procedurale apo të çfarëdo natyre tjetër, emërtuesi i përbashkët i këtyre shpërdorimeve është Korrupsioni.

Shqetësimin për rritjen e nivelit të korrupsionit e ka shpërfaqur edhe i ambasadori amerikan në Kosovë në ceremoninë e diplomimit të kandidatëve të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për gjyqtarë dhe prokurorë.

“Korrupsioni është përhapur aq shumë dhe është bërë aq i zakonshëm në çdo nivel këtu, sa që e tërë shoqëria e nënkupton gjuhën e tij. Kështu ajo mund të mbetet e pathënë dhe të korruptuarit parapëlqejnë të qëndrojnë nën hije”¹

Shprehjet e përdorura nga ambasadori në këtë deklaratë e vënë në pah një problem tjetër madhor, mungesën e kulturës politike, e cila do ta nxiste transparencën dhe llogaridhënien.

“Korrupsioni është bërë i zakonshëm dhe mund të mbetet i pathënë”.

Në një shtet në tranzicion siç është Kosova një problem kaq fundamental gjithsesi ndikon negativisht në kredibilitetin e shërbimeve publike dhe qasjen e qytetarëve në to. Qytetarët rregullisht ndeshen me korrupsionin në polici, dogana dhe shërbimet gjyqësore.²

Por, çfarë bëhet në të vërtetë për ta luftuar këtë dukuri që po e dëmton seriozisht zhvillimin e gjithëmbarshtëm të Kosovës? Për luftimin e kësaj dukurie shumëçka është bërë në letër, por rezultatet praktike lënë shumë për të dëshiruar.

¹ <http://kohaditore.com/?page=1,13,94449>, e vizituar së fundi më 10.04.2012

² Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, fq. 13. 2011

Për t'u ballafaquar me këtë dukuri, krahas institucioneve tradicionale të zbatimit të ligjit siç janë policia, organet e ndjekjes penale dhe të gjyqimit, janë themeluar edhe një varg mekanizmesh institucional të pavarur apo koordinues. I fundit ndër ta u themelua Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit, i udhëhequr nga presidentja e Republikës së Kosovës, në të cilën janë përfshirë mekanizmat kryesor institucional përgjegjës për këtë fushë.

Por përkundër ekzistimit të mekanizmave të tillë, rezultati në luftën kundër korrupsionit ende mbetet e pavërejtshëm. Për më tepër ekziston rreziku i madh i krijimit të disa adresave institucionale, për këtë çështje. Kjo shkakton konfuzion tek qytetarët përkitazi me adresën e vërtetë për luftimin e këtij fenomeni e për pasojë edhe ikjen nga përgjegjësia institucionale.

Në një shtet në tranzicion siç është Kosova, themelet e besimit qytetar duket se janë ende të zbehta. Nevojiten përpjekje serioze jo vetëm me dokumente politike anti-korrupsion, por edhe në mendësinë e pastër qytetare, që të sigurohet pjesëmarrja e gjithsecilit në luftën kundër kësaj dukurie. Gjithashtu nevojitet ndërgjegjësim i zyrtarëve publik për përgjegjësinë e postit që bartin.

Qëllimi i Analizës dhe Metodologjia

Kjo analizë synon që të ofrojë një tablo të përgjithshme mbi natyrën e këtyre shkeljeve korruptive, përgjegjësitë institucionale dhe përpjekjet e këtyre institucioneve në përballjen e tyre kundër korrupsionit, sfidat, rezultatet si dhe të përpiqet që të ofrojë perspektivat për fuqizimin e këtyre përpjekjeve.

Për të arritur këtë synim, do të analizohen në mënyrë kritike të dhënat zyrtare të mekanizmave kryesorë të kyçur në luftën kundër korrupsionit si dhe të identifikohen pengesat reale, për kurorëzimin e suksesshëm të këtyre përpjekjeve.

II. Shkeljet me Natyrë Korruptive gjatë Procedurave të Prokurimit Publik

Prezenca shqetësuese e dukurisë së korrupsionit, vazhdon t'i shkaktojë Kosovës dëme të konsiderueshme në shumë fusha, sidomos në perspektivën ekonomike të saj. Zbatimi ligjor i vështirë, i gjatë dhe i kushtueshëm i kontratave dhe korrupsioni i përhapur vazhdon ta pengojë mjedisin e biznesit.³

Siç e dëshmon edhe Raporti i Progresit për Kosovën i Komisionit Evropian për vitin 2011, disa përpjekje në drejtim të luftës kundër korrupsionit janë bërë. Ka pasur disa dënime në lidhje me rastet e korrupsionit. Që nga janari i vitit 2009, një total prej 30 vendimesh janë nxjerr nga panelet e përbërë nga gjyqtarë të EULEX-it dhe gjyqtarë të Kosovës, 30 të akuzuar janë gjetur fajtorë, 6 janë liruar. Në lidhje me rastet e tjera të korrupsionit, 216 raste janë trashëguar nga vitet e kaluara dhe 92 janë raportuar në periudhën tetor 2010 – korrik 2011. 75 raste janë zgjedhur në instancën e parë (40

nga të cilat me aktgjykim dënues) në këtë periudhë.⁴

Pavarësisht këtyre përpjekjeve nuk janë arritur rezultate evidente në luftën kundër korrupsionit. Ekziston nevoja për të trajtuar këtë sfidë në mënyrë më pro-aktive, në veçanti nga autoritetet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore⁵

Është detyrë ligjore e autoriteteve kontraktuese që gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre të prokurimit, të zbatojnë dhe respektojnë kërkesat procedurale dhe përmbajtjesore të Ligjit të Prokurimit Publik⁶ si dhe " të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit".⁷ Por, në shumicën e rasteve ky obligim ligjor mbetet vetëm në letër ndërsa shkeljet ligjore gjatë procedurave të prokurimit publik janë të shumta.

Ne Raportin vjetor të Agjencisë kundër korrupsionit për periudhën

³ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, fq. 29. 2011.

⁴ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, fq. 13. 2011

⁵ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, fq. 13. 2011.

⁶ Neni 2 parag. 1 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

⁷ Neni 6 parag. 1 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

01 Dhjetor- 31 Dhjetor 2011 konstatohet se shkeljet me natyrë korruptive paraqiten gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik edhe atë “duke filluar nga përgatitja e dosjeve të tenderëve si: hartimi i dosjeve të tenderëve në kundërshtim me ligjin dhe rregulloren për prokurim publik, caktimi i kundërligjshëm i kriterëve të përzgjedhjes me qëllim favorizimi të operatorëve ekonomik të caktuar, etj”.⁸

Me rastin e ndarjes së buxhetit për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme, zyrtarët përgjegjës për kryerjen e procedurave të prokurimit, fillojnë “bisedimet” me operatorët ekonomik, në mënyrë që këta të fundit të plotësojnë të gjitha parakushtet për të fituar kontratat publike, Kësisoj krijohen favorizime të kundërligjshme që ju bëhen disa OE-ve për përfitime personale.

Në një intervistë për Radio “Evropa e Lirë”, Arian Zeka ushtrues i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv në Odën Ekonomike Amerikane, potencoi se: “Te praktikat e prokurimit publik, kemi shkelje jashtëzakonisht të mëdha aty. (...) Çështje shumë shqetësuese është

fakti që kur bëhet shpallja e tenderëve të ndryshëm, specifikimet teknike shkruhen në atë mënyrë që ato e paragjykojnë paraprakisht se kush do të jetë fitues i atij tenderi meqenëse kërkohen gjëra të cilat përmbushen vetëm nga një kompani e caktuar. Kjo është shkelje jo vetëm e Kushtetutës së vendit, por është shkelje edhe e Ligjit të prokurimit publik, i cili e ndalon hapur hartimin e specifikave të tenderëve në atë mënyrë që favorizojnë një ofertues apo edhe i disfavorizojnë një apo më shumë të tjerë.⁹

Raporti vjetor i Agjencisë kundër Korrupsionit po ashtu evidenton se edhe në fazën e vlerësimit të ofertave paraqiten shkelje si: favorizime të kundër ligjshme për OE të caktuar, vazhdimi i procedurave të prokurimit edhe pse nuk janë përmbushur kërkesat e Ligjit për Prokurim Publik.

Shumë herë ndodh që vazhdohet me procedurat edhe pse numri i ofertuesve minimal i kërkuar me ligj nuk plotësohet ose kompanitë fitojnë tenderët pa pasur dokumentacionin e kompletuar.

⁸ Raporti Vjetor i Agjencisë kundër Korrupsionit për periudhën 01 janar – 31 dhjetor 2011. fq.11.

⁹

<http://www.evropaelire.org/content/article/24586269.html?fromExternalEidget=true>, e vizituar më 19.05.2012.

Është shqetësues fakti se zyrtarët e prokurimit publik krijojnë raporte miqësore me përfaqësuesit e OE-ve fituese, gjë që ndikon në besueshmërinë e procedurave të prokurimit publik, të udhëhequra prej këtyre zyrtarëve publik.

Faza e mbikëqyrjes së realizimit të punëve, ofrimit të shërbimeve dhe furnizimit, po ashtu karakterizohet me shkelje ligjore nga më të ndryshmet si:

- anëtarët e komisionit mbikëqyrës propozojnë kryerjen e pagesave të kundërligjshme edhe në rastet kur punët nuk kanë përfunduar sipas planit të paraparë
- shërbimet dhe furnizimet nuk janë ofruar sipas kontratës
- planet dinamike nuk janë respektuar nga operatorët ekonomik
- nuk kërkohet arsyetim nga OE-të për vonesën në kryerjen e punëve apo ofrimin e shërbimeve dhe furnizimit
- porositen produkte të caktuara për autoritetin kontraktues dhe më pastaj refuzohet kundërligjshëm pranimi i tyre duke i

shkaktuar dëm buxheti të Kosovës,¹⁰

Sipas Raportit Vjetor të Agjencisë kundër Korrupsionit “Falsifikimi i Dokumenteve Zyrtare është një shkelje ligjore tjetër karakteristike e rasteve të hetuara, në të gjitha kategoritë e institucioneve në Republikën e Kosovës. Gjatë hetimeve janë gjetur prova, të cilat tregojnë për falsifikim masiv të dokumenteve zyrtare me qëllim të dhënies së kontratave publike operatorëve ekonomik përkatës. Gjithashtu është vërejtur falsifikimi i raporteve për kryerjen e punëve të cilat në fakt nuk janë kryer e në bazë të të cilave është bërë edhe pagesa nga autoritetet kontraktuese. Më tej gjetjet kanë nxjerrë në pah edhe falsifikimin e nënshkrimit në procedura gjyqësore dhe po ashtu falsifikimin e vërtetimeve për kryerjen e obligimeve ndaj shtetit.

Kompanitë fituese përpos që dorëzojnë faturat në institucionet publike, ata janë në dijeni edhe për buxhetin e tyre, procedurën e pagesës dhe shprehin interesim të

¹⁰ Raporti Vjetor i Agjencisë kundër Korrupsionit për periudhën 01 janar – 31 dhjetor 2011. fq.11.

theksuar duke penguar zyrtarët financiar në kryerjen e detyrave ditore me pyetjet dhe shqetësimet e kohëpaskohshme. Kjo qasje shkakton trysni lidhur me kryerjen e pagesave në procedurë sa më të shpejtë e jo sipas afateve të përcaktuara ligjore për ekzekutimin e pagesave.

Mbetet problematike ndërhyrja e stafit politik në drejtim të dhënies së “udhëzimeve”, për dhënien e tenderëve dhe kryerjen e pagesave për firmat e caktuara.

Natyrisht se të gjitha këto shkelje ligjore ndodhin si pasojë e keqpërdorimit të rëndë të detyrës zyrtare nga ana e zyrtarëve të prokurimit të institucioneve publike, të cilët në shumicën e rasteve janë të emëruar. Ata realisht veprojnë dhe mbikëqyren nga partitë politike. Kjo e bënë korrupsioni tërësisht të lidhur me partitë politike dhe si konsekuencë e saj edhe luftimi kundrejt tij mbetet plotësisht në vullnetin politik të tyre.

Natyrisht se të gjitha këto elemente kontribuojnë jashtëzakonisht shumë në cenimin e integritetit të zyrtarëve të prokurimit publik. Ashtu siç edhe vlerëson Raporti i

Progresit, ka nevojë urgjente për fuqizimin e pavarësisë së zyrtarëve të prokurimit publik.

Më poshtë do të prezantojmë të dhënat në lidhje me përgjegjësitë ligjore dhe aktivitetet përkatëse të institucioneve kompetente në fushën e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik si dhe mekanizmave institucional kompetent, për të luftuar keqpërdorimet gjatë zhvillimit të këtyre procedurave.

III. Organet Rregulative dhe Ekzekutive në Fushën e Prokurimit Publik

Në Kosovë funksionojnë tri organe qendrore në fushën e prokurimit publik: Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) dhe Agjencia Qendrore e Prokurimit (APP). Më poshtë po prezantojmë përgjegjësitë kryesore ligjore të tyre si dhe veprimtarinë e tyre, bazuar në raportet e tyre vjetore për vitin 2011.

3.1. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

Sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik “është agjenci e pavarur rregullatore”¹¹, e cila “është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë”¹².

KRPP-ja ka përgjegjësi të mbikëqyr zbatimin e përgjithshëm të LPP-së dhe procedurat e prokurimit, të zhvillojë rregulla dhe interpretime të hollësishme si dhe të jap ndihmë dhe mbështetje teknike OE dhe

Autoriteteve Kontraktuese për zbatimin e këtij ligji, të mbështes autoritetet publike të trajnimit dhe arsimimit sic është IKAP me qëllim që të sigurohet arritja dhe mbajtja e një niveli të lartë kompetence në radhë të zyrtarëve të Prokurimit, të mbështes komunikimin brenda fushës së prokurimit dhe të bashkëpunojë me organizata tjera brenda dhe jashtë vendit në fushën e prokurimit. Përgjegjësit dhe detyrat e KRPP-së janë të përshekruara në detaje në LPP.¹³

KRPP gjithashtu ka përgjegjësinë të përgatisë dhe të mbajë një listë të autoriteteve kontraktuese. Nga gjithsej 161 autoritete kontraktuese sa kanë ekzistuar në Kosovë në fund të vitit 2011, 158 autoritete kontraktuese me kohë i kanë dorëzuar raportet vjetore, 3 autoritete kontraktuese fare nuk i kanë dërguar raportet vjetore. Autoritetet kontraktuese të cilat nuk i kanë dorëzuar raportet vjetore, janë tri komuna nga pjesa veriore e Kosovës; Komuna e Zveqanit, e Zubin Potokut dhe e Leposaviqit.¹⁴

Bazuar në raportet e dërguara nga autoritetet kontraktuese. Në to

¹¹ Neni 86 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

¹² Neni 87 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

¹³ Neni 87 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

¹⁴ Raport mbi Aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë për vitin 2011. KRPP, fq. 6.

shihet se gjatë vitit 2011, në tërë Kosovën janë nënshkruar 12310 kontrata publike të udhëhequra sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, duke i përfshirë të gjitha llojet e vlerave të kontratave.¹⁵

Departamenti për monitorim dhe mbikëqyrje i KRPP-së (...) gjatë vitit kalendarik 2011 ka monitoruar dyzet (40) autoritete kontraktuese të planifikuara me gjithsej 218 aktivitete të prokurimit. Gjatë monitorimit të aktiviteteve kontraktuese nga departamenti i monitorimit, janë konstatuar këto shkelje – mosrespektime të neneve të LPP-së nr. 02/L-99 dhe Rregullores së prokurimit publik: barazia në trajtim- 2 raste, planifikimi i Prokurimit- 41 raste, përcaktimi i nevojave -11 raste, zotimi i mjeteve -22 raste, deklarata e nevojave dhe domosdoshmërisë së fondeve -44 raste, ndarja e kërkesave- 1 rast, inicimi i aktivitetit të prokurimit- 2 raste, dosja e tenderit- 19 raste, specifikimet teknike- 5 raste, revokimi i nenit pas pranimit të më pak se tri ofertave të përgjegjshme -6 raste, autorizimi nga APP-ja për punë-shërbime shtesë- 2 raste, caktimi i pozicionit të punëve të papaparapara

në dosjen e tenderit- 7 raste, afati më i shkurtër se 10 ditë për kuotim 1 rast, më pak se tri oferta – kuotime të përgjegjshme- 3 raste, njoftimi për dhënien e kontratës -4 raste, njoftimi për dhënien e kontratës në ueb faqen e KRPP-së, 24 raste, njoftimi për kontratë në gazeta ditore- 1 rast, afatet e tenderimit- 4 raste, rregullat e posaçme për shkurtimin e afatit kohor- 9 raste, informata sqaruese për të gjithë OE konkurrues 1 rast, caktimi i nënkritereve- 22 raste, njoftimi i ofertuesve të pa përgjegjshëm dhe të pasuksesshëm- 88 raste, hapja e ofertave pas datës së paraparë- 1 rast, pranimi i kuotimit të çmimit pas hapjes së ofertave- 1 rast, njoftimi i OE për përmirësimin e gabimeve aritmetikore- 5 raste, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve -19 raste, kërkesa për sqarim të OE konkurrues për ofrimin e çmimit jo normalisht të ulët para eliminimit të tij nga konkurrenca -1 rast, sigurimi i ekzekutimit dhe dorëzimi i tij para nënshkrimit të kontratës -31 raste.¹⁶

KRPP-ja përveç përgjegjësive ligjore rregullative të lartë përmendura ka edhe përgjegjësi ekzekutive. Kjo vërehet sidomos kur bëhet fjalë për

¹⁵ Raport mbi Aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë për vitin 2011. KRPP, fq. 6.

¹⁶ Shih Raportin mbi Aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë për vitin 2011. KRPP fq. 39 - 40

përgjegjësinë e KRPP-së, për të "hetuar aktivitetet e prokurimit dhe menaxhimit të kontratave për qëllim të monitorimit të zbatimit të Ligjit të Prokurimit Publik" pastaj "të lëshoj një urdhëresë që kërkon nga zyrtarët e zbatimit të ligjit të asistojnë KRPP-në, që të sigurojnë përputhshmërinë me një urdhëresë tjetër të KRPP-së".

3.2. Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) është organ i pavarur shqyrtues i cili ushtron autoritetin, kompetencat, funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin e Prokurimit Publik dhe "përbëhet nga pesë (5) anëtarë; të gjithë anëtarët emërohen për një mandat pesë (5) vjeçar dhe mund të riemërohen vetëm një herë".¹⁷ Nga ky kuptim OSHP është organ kolegjal, i cili vendimet i merr në përbërje kolegjiale.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi: që përmes paneleve të veta shqyrtuese, të cilat i cakton

kryetari i OSHP-së të zbatoj procedurat ankimore për shqyrtimin e lëndëve të prokurimit sipas pjesës XIII të LPP-së. Ky organ ka autoritet dhe përgjegjësi ligjore për këtë pjesë të ligjit, konform afateve ligjore të nxjerrë një vendim me shkrim për mënyrën e vendosjes së asaj lënde, objekt i të cilës është shqyrtimi i prokurimit publik. Gjithashtu OSHP-ja ka autorizim dhe përgjegjësi që të rishikojë dhe vendos vlefshmërinë e çdo vendimi, veprimi, mase, interpretimi ose rregullimi të nxjerrë, të përdorur ose shpallur nga Agjensioni i Prokurimit Publik ose KRPP-ja.¹⁸

OSHP-ja për punën e vet i raporton një herë në vit Kuvendit të Republikës së Kosovës, për mbarëvajtjen e procedurave të shqyrtimit të prokurimit publik, në përputhje me pjesën e XIII të LPP-së. Të gjitha vendimet dhe urdhrat e OSHP-së (...) mund të shqyrtohen nga Gjykata Supreme, në pajtim me ligjin për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative dhe me nenin 119 të këtij ligji.¹⁹

¹⁷ Shih nenin 98.1 dhe 100.1 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

¹⁸ <http://oshp.rks-gov.net/?cid=1,84>

¹⁹ Neni 99 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Nga gjithsej 419 ankesa të pranuar, 386 janë ankesa të parashtruara nga operatorët ekonomik kundër vendimeve të autoriteteve kontraktuese për dhënie e kontratës, ndërsa 30 kërkesa janë të Autoriteteve Kontraktuese për shqyrtimin e vendimeve të APP-së dhe tri (3) kërkesa janë të Autoriteteve Kontraktuese kundër interpretimit të KRPP-së.²⁰

Bazuar në Raportin Vjetor të OSHP-së për vitin 2011 shkeljet ligjore dhe parregullsitë e përsëritura nga ana e Autoriteteve Kontraktuese, janë gjetur veçanërisht në disa nga aspektet më të rëndësishme të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik si: parregullsi gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe në marrjen e vendimeve të gabuara për shpalljen e fituesit dhe shkelje të tjera të LPP-së .

Me qëllim të ilustrimit të parregullsive në paragrafin në vazhdim japim disa statistika të punës së OSHP-së :

OSHP-ja gjatë vitit 2011, konform nenit 118 të LPP-së ka konfiskuar shumën totale prej: 89.500.00 euro, për shkak se pretendimet ankimore

të Operatorëve Ekonomik kanë qenë të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Gjithashtu vendimet për dhënie të kontratave kanë qenë të drejta dhe konform dispozitave të LPP-së.²¹

Gjatë vitit 2011, OSHP-ja me vendimet që ka marr me rastin e kthimit të lëndëve në ritenderim dhe rivlerësim, ka kursyer buxhetin e Kosovës në vlerë prej: 4.335.234.34 €. ²²

OSHP-ja duke u bazuar në nenin 130 të LPP-së për shkak mosrespektimit të vendimeve të Paneleve Shqyrtuese nga ana e Autoriteteve Kontraktuese, ka shqiptuar gjoba në vlerë totale prej: 131.000.00 euro.²³

Prej vlerës totale të gjobave të shqiptuara vetëm shuma prej: 63.000.00 euro është inkasuar në xhirollogarinë e OSHP-së, ndërsa vlera e gjobave tjera nuk është inkasuar për shkak se AK-së kanë iniciuar kërkesë-padi në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe janë duke u zhvilluar procedurat gjyqësore edhe pse vendimet e Paneleve Shqyrtuese të OSHP-së, janë të formës së prerë, Për habi Thesari-MEF-i, nuk i zbaton ato me

²⁰ Raporti Vjetor i Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2011, fq. 20.

²¹ Po aty, Fq.21.

²² Po aty, Fq.28.

²³ Po aty, Fq.33.

arsyetimin se ky institucion, i ekzekuton vetëm vendimet e plotfuqishme të gjykatave kompetente e jo edhe ato të organeve administrative, siç është edhe rasti me OSHP-në.²⁴

Nga totali prej 386 ankesave të shqyrtuara, në 25 raste me kërkesë-padi nga ana e palëve të pakënaqura është iniciuar procedurë e konfliktit administrativ në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.²⁵

Por, është e diskutueshme kompetenca ligjore e dhënë me nenin 106 të Ligjit të Prokurimit Publik, me të cilin Kryetarit të OSHP-së i është dhënë përgjegjësia që "Varësisht nga vlera apo madhësia e kontratës së propozuar apo bazuar në vështirësinë ose rëndësinë e çështjes së ngritur nga ky rast, Kryetari i OSHP-së do të jetë përgjegjës për themelimin e rregullave të brendshme në lidhje me emërimin e anëtarëve për një panel shqyrtues të tillë. Paneli shqyrtues mund të përbëhet nga një (1), tre (3) ose pesë (5) anëtarë.²⁶

Me Rregulloren e Punës së OSHP-së, Kryetarit të OSHP-së i është dhënë mundësia "të vendosë në lidhje me përbërjen e Paneleve Shqyrtuese si dhe emërimin e anëtarëve të OSHP-së, në Paneli Shqyrtues, në pajtim me Nenin 23 të rregullores aktuale të punës".²⁷

Nisur nga fakti se OSHP-ja është organ kolegjal, emërimi i paneleve shqyrtuese do të duhej të ishte përgjegjësi e këtij organi në tërësi, e jo vetëm e Kryetarit të saj. Një veprim i tillë krijon mundësinë e keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga ana e personit që ushtron këtë funksion ndërsa përveç tjerash, zbeh transparencën e procesit të emërimit. Pra, pozicioni i Kryetarit të OSHP-së, në raport me anëtarët e tjerë të OSHP-së duhet të jetë "I pari ndër të barabartët" dhe që vendimmarrja për të gjitha çështjet që janë në kompetencë të OSHP-së duke përfshirë edhe emërimin e paneleve shqyrtuese, duhet të jetë kolegjiale e jo individuale.

²⁴ Po aty, fq. 33.

²⁵ Po aty, fq. 34.

²⁶ Neni 106 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

²⁷ Neni 11.5 i Rregullores së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik të Kosovës, mars 2012.

3.3. Agjencia Qendrore e Prokurimit Publik

Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, në Ministrinë përkatëse për Financa themelohet Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). AQP-ja do të zbatojë dhe kryejë funksione dhe përgjegjësi të specifikuara me këtë ligj. Të gjitha pasuritë, duke përfshirë të gjitha arkivat dhe objektet në shfrytëzim nga APP-ja dhe personeli i APP-së transferohen te Agjencia Qendrore e Prokurimit.²⁸

AQP-ja ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- zhvillimin e prokurimeve të përbashkëta për Autoritete Kontraktuese
- me kërkesën e Autoriteteve Kontraktuese kryen aktivitetet e prokurimit në emër të tyre
- me kërkesën e Autoriteteve Kontraktuese ndihmon në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit²⁹

- qeveria sipas propozimit të Ministrisë për financa vendos një listë të mallrave ose artikujve të përdorimit të përbashkët, prokurimi i të cilëve i është caktuar AQP.

Kjo listë miratohet në formën e një Udhëzimi Administrativ. Kjo listë dhe çdo ndryshim i saj duhet të publikohen në media dhe të shpallen në faqen e internetit të KRPP-së (...)³⁰.

Nisur nga këto kompetenca të Agjencisë së Prokurimit Publik, mund të vërehen dy tendenca kryesore të mundshme.

Tendenca pozitive e cila nisët nga mundësia e shfrytëzimit të ekspertizës profesionale, racionalizimit të kostos dhe kohës së nevojshme për blerjen e artikujve të përbashkët për disa autoritete kontraktuese, në vend që të zhvillohen disa procedura të prokurimit në të njëjtën kohë dhe për të njëjtat produkte qeveritare. Ndërkaq tendenca negative nisët nga realiteti konkret me të cilën ekziston rreziku i madh, që të centralizohet mundësia e zhvillimit

²⁸ Neni 94 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

²⁹ <https://aqp.rks-gov.net/sq/Rreth-AQP-se>

³⁰ Neni 95, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

të procedurave të prokurimit publik për mallrat dhe artikujt e caktuar qeveritar. Bashkë me të mund të ndodh edhe centralizimi i mundësisë së keqpërdorimit të këtyre procedurave për qëllime të përfitimit të kundërligjshëm.

3.4. Koordinimi Ndërinstitucional

Sic përcaktohet edhe nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2011, “ekziston një mbivendosje ndërmjet tri organeve publike të prokurimit (Agjencia e Prokurimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe Këshilli Rregullativ i Prokurimit) dhe ndarja ndërmjet pushteteve rregullative dhe ekzekutive nuk është plotësisht e përcaktuar”.³¹

Nisur nga kjo është e diskutueshme arsyeshmëria e ekzistimit të tri organeve qendrore në fushën e prokurimit publik. Autoriteti rregullues dhe ekzekutiv qendror në fushën e prokurimit, mund të ushtrohet nga një organ i vetëm me kapacitete të plota njerëzore dhe profesionale.

VI. Organet Kompetente Për Luftimin e Korrupsionit në Procedurat e Prokurimit Publik

Kosova vazhdon të ballafaqohet me sfida domethënëse në luftimin e korrupsionit. Legjislacioni i aprovuar tani duhet të implementohet plotësisht. Kapaciteti për të hetuar këtë lloj të krimit dhe niveli i ekspertizës mbetet i kufizuar.³² Nisur nga kjo, po i prezantojmë aktivitetet e Prokurorisë së Shtetit dhe Agjencisë kundër Korrupsionit, në luftimin e korrupsionit.

4.1. Prokuroria e Shtetit

Prokurori i Shtetit nënkupton institucionin e pavarur kompetent dhe përgjegjës për ndjekjen e personave të dyshuar, për kryerjen e veprave penale dhe veprave tjera siç ceken me ligj. Prokurori i Shtetit sipas ligjit është i autorizuar që të iniciojë hetime penale, të paraqesë aktakuzën apo propozim akuzën, të zhvillojë ndjekjen penale, të kryejë detyra apo funksione të tjera prokuroriale që janë në përputhje

³¹ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, fq. 38. 2011.

³² Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, fq. 13. 2011.

me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet e zbatueshme.³³

Prokuroritë e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2011, kanë pasur në punë 959 kallëzime penale kundër 1862 personave, që kanë të bëjnë me korrupsionin. Nga vitet paraprake janë trashëguar 467 kallëzime penale ndërkaq gjatë vitit 2011, janë pranuar në punë edhe 492 kallëzime penale.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2011, prokuroritë e vendit kanë zgjedhur 538 kallëzime penale kundër 1038 personave ndërkaq kanë mbetur të pazgjidhura 421 kallëzime penale kundër 824 personave. Rastet e zgjidhura gjatë vitit 2011, kanë përfunduar si në vijim:

- Janë ngritur 107 propozim akuza kundër 139 personave,
- Janë ngritur 107 aktakuza kundër 478 personave,
- Janë hedhur 165 kallëzime penale kundër 216 personave dhe
- Janë pushuar 31 hetime kundër 71 personave.³⁴

³³ Raport për Punën e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011, fq. 2.

³⁴ Raporti i Punës Vjetore (janar – dhjetor 2011), të prokurorive të Republikës së Kosovës, për lëndët që kanë të bëjnë me korrupsionin, Prishtinë, 7 shkurt 2012.

Përkundër të dhënave të mësipërme, ekziston një perceptim i përgjithshëm te opinioni publik, se këto përpjekje nuk janë të mjaftueshme për të penguar shtrirjen e mëtejshme të korrupsionit në shoqëri. Tendencat e rritjes së mëtejme të tij të theksuara nga të gjitha raportet ndërkombëtare dhe vendore, më së miri e provojnë një perceptim të tillë.

Është më se i domosdoshëm fuqizimi i mëtejme i përpjekjeve nga ana e prokurorisë publike, pasi që te ky institucion në radhë të parë bie përgjegjësia e zbulimit dhe ndjekjes penale të kryesve të veprave penale të natyrës korruptive. Një nevojë e tillë vihet në dukje edhe nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian në të cilin theksohet se “Autoritetet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore, duhet të jenë më pro-aktive në këtë fushë”.³⁵

4.2. Agjencia Kundër Korrupsionit

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) është institucion i pavarur i themeluar në korrik të vitit 2006

³⁵ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, fq. 13. 2011.

ndërsa ka filluar të funksionojë më 12 shkurt të vitit 2007.³⁶

Për sa i takon strukturës së rasteve të hetuara nga AKK-ja gjatë vitit 2011, “në 160 raste për të cilat AKK-ja ka filluar procedurën e hetimeve paraprake janë të përfshira Gjykatat e Republikës së Kosovës, institucionet tjera, Qeveria e Republikës së Kosovës, pushteti lokal dhe prokuroritë e Republikës së Kosovës”. (...) Gjatë periudhës raportuese në institucionet kompetente për procedim të mëtutjeshëm penal, janë përcjell 39 informata dhe kallëzime penale³⁷, nga të cilët janë denoncuar 121 persona³⁸.

Nga numri i përgjithshëm i rasteve të proceduara në prokuroritë publike dhe organet policore kompetente, numrin me të madh të tyre e përbëjnë veprimet korruptive të parapara sipas nenit 339 të KPK-së pra Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit.

Sipas natyrës së veprës penale janë përcjell 33 informata dhe kallëzime penale³⁹, ndërsa “Në rastet më të

shpeshta veprimet apo mos veprimet e përmendura, i referohen shkeljes së procedurave të prokurimit apo në rastet më të këqija, anashkalimi i tërësishëm i këtyre procedurave”.⁴⁰

AKK-ja që nga funksionalizimi e deri në momentin e raportimit nga të gjitha rastet e hetuara ku janë gjetur prova për vërtetimin e dyshimeve për veprime korruptive, i ka përcjell në prokuroritë publike kompetente si dhe prokurorinë e EULEX-it 240 raste. Nga ky numër prokuroritë kanë dhënë informacion kthyes duke konfirmuar se 76 raste janë në procedurë hetimore, për 12 prej tyre janë ngritur propozim akuza dhe aktakuza, për 6 raste të përcjella është kryer arrestimi i të dyshuarve për veprime korruptive si rezultat i bashkëpunimit në mes AKK-së me Prokurorinë publike dhe Policinë e Kosovës, për 66 raste është konfirmuar se janë hedhur poshtë ndërsa për 80 raste të përcjellura nuk ka informata kthyes.⁴¹

Numri kaq i madh i rasteve të refuzuara nga prokuroria dhe i rasteve për të cilat AKK-ja nuk ka informacion kthyes nga prokuroria

³⁶ Raporti Vjetor i Agjencisë kundër Korrupsionit për periudhën 01 dhjetor – 31 dhjetor 2011. Fq. 3.

³⁷ Raporti Vjetor i Agjencisë kundër Korrupsionit për periudhën 01 dhjetor – 31 dhjetor 2011, Fq.7.

³⁸ Po aty fq.8.

³⁹ Po aty, fq.9.

⁴⁰ Po aty, fq. 11.

⁴¹ Po aty, fq. 15.

dëshmon për nevojën e rritjes së bashkëpunimit në mes të prokurorisë publike dhe AKK-së. AKK-ja dhe prokuroria publike duhet të bashkëpunojnë në të gjitha fazat e zbulimit dhe hetimit të rasteve të korrupsionit, brenda mandateve ligjore respektive. Një bashkëpunim i tillë i ngushtë është i domosdoshëm për hetimin dhe ndjekjen efikase të kryesve të dyshuar të veprave penale me natyrë korruptive. Një gjë e tillë potencohet edhe nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian, në të cilin kërkohet që: “Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Kundër-Korrupsionit, policisë dhe prokurorisë duhet të përmirësohet më tutje”.⁴² Në këtë aspekt, AKK-ja do të duhej të pajiset me përgjegjësi ligjore për të bërë hetime penale, duke u autorizuar nga prokurori publik, me çka do të institucionalizohej bashkëpunimi i ngushtë midis këtyre dy autoriteteve publike.

AKK-ja, përveç aktiviteteve në fushën e hetimit të rasteve të korrupsionit, ka ndërmarrë edhe masa të tjera. “Me qëllim të parandalimit të korrupsionit, ka trajtuar shumë burime dhe ka

intervenuar në rastet kur ka pasur dyshim se ka mosrespektim të ligjit në fushën e prokurimit. AKK-ja gjatë vitit raportues ka trajtuar gjithsej 20 lëndë në fushën e prokurimit publik. Gjatë trajtimit të tyre; 1 lëndë është dërguar për hetim paraprak në Departamentin e Hetimeve; 12 opinione; 4 të mbyllura pa efekt juridik; 2 pjesëmarrje si vëzhgues dhe 1 rast është në procedurë”.⁴³

Një nga aktivitetet e diskutueshme në aspektin ligjor dhe institucional është aktiviteti i kësaj Agjencie, në ndërhyrjen në aktivitetet e prokurimit me qëllim të parandalimit të korrupsionit e posaçërisht pjesëmarrja si vëzhgues në procedurat e prokurimit publik. Monitorimi i këtyre procedurave me qëllim të parandalimit të shpërdorimeve eventuale, duhet të jetë në radhë të parë mandat ligjor i organeve kompetente në fushën e shqyrtimit të ankesave në procedurat e prokurimit publik siç është OSHP-ja. Ndërsa AKK-ja duhet të intervenojë vetëm në rastet kur shkelja dyshohet se ka ndodhur, pa e paragjykuar atë paraprakisht.

⁴² Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, fq. 13. 2011.

⁴³ Raporti Vjetor i Agjencisë kundër Korrupsionit për periudhën 01 dhjetor – 31 dhjetor 2011. fq. 30.

V. Konkluzionet dhe Rekomandimet

Përmasat e korrupsionit në Kosovë janë shqetësuese, ndërsa edhe më shqetësuese është mungesa e rezultateve evidente, në luftimin dhe parandalimin e këtij “kanceri të shoqërisë”.

Shfaqja e kësaj dukurie është e pranishme sidomos te procedurat e prokurimit publik, duke e bërë këtë proces shumë shpesh jo kredibil në sytë e qytetarëve. Shkeljet me natyrë korruptive paraqiten gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

Në fazën e përgatitjes së dosjes së tenderit hasen shkeljet si: hartimi i dosjeve të tenderëve në kundërshtim me ligjin dhe rregulloren për prokurim publik, caktimi i kundërligjshëm i kriterëve të përzgjedhjes me qëllim favorizimi të operatorëve ekonomik të caktuar etj.

Në fazën e vlerësimit të ofertave paraqiten shkelje si: rekomandime që me kontrata publike të shpërblehen operatorët ekonomik të favorizuar duke eliminuar nga procedura e prokurimit operatorët ekonomik të përgjegjshëm,

rekomandimi që të vazhdohet me zbatimin e procedurave të prokurimit përkundër faktit se paraqitet numër më i vogël i ofertave të përgjegjshme se sa minimumi i kërkuar me ligj pastaj lidhja e kontratave publike me operator ekonomik ku pronar janë persona të afërm familjar, po ashtu lidhja e kontratës publike sipas marrëveshjes paraprake me operatorin ekonomik ku bashkëpronar është ndonjëri nga zyrtarët me pozitë vendimmarrëse në institucionin si autoritet kontraktues, mos nënshkrimi i kontratës me operatorin ekonomik fitues etj.

Në fazën e mbikëqyrjes së realizimit të punëve, ofrimit të shërbimeve dhe furnizimit shkeljet më të shpeshta karakterizohen me atë se anëtarët e komisionit mbikëqyrës, propozojnë kryerjen e pagesave të kundërligjshme edhe në rastet kur punët nuk kanë përfunduar sipas planit të paraparë apo shërbimet dhe furnizimet nuk janë ofruar sipas kontratës, planet dinamike nuk janë respektuar nga operatorët ekonomik, porositen produkte të caktuara për autoritetin kontraktues dhe më pastaj refuzohet në mënyrë të kundërligjshme pranimi i tyre,

duke i shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës.

Problematik vazhdon të mbetet mosrespektimi i afatit kohor të kompanive fituese për realizimin e punëve të parapara me kontratë. Ato vazhdojnë kryerjen e këtyre punëve pa dhënë asnjë llogari se cila është arsyeja e moskryerjes së punëve brenda afatit kohor të përcaktuar me kontratë, ndërsa kompanive në fjalë në vazhdimësi u bëhet pagesa për punët e moskryera.

Ka raste kur operatorët ekonomik fitojnë tenderë duke prezantuar të dhëna të rrejshme, për gjoja kryerjen e detyrimeve shtetërore. Ato përdorin emra fiktiv të personelit profesional si dhe duke falsifikuar kontrata të punësimit me individ të cilët nuk kanë qenë asnjëherë të punësuar në kuadër të operatorëve përkatës, shënojnë informacione të rrejshme në procesverbale të hapjes dhe vlerësimit me qëllim favorizimit të operatorëve ekonomik fitues. Gjithashtu falsifikojnë raportet për kryerjen e punëve, të cilat në fakt nuk janë kryer e në bazë të të cilave është bërë pagesa nga autoritetet

kontraktuese. Së fundi është vërejtur edhe falsifikimi i nënshkrimit në procedura gjyqësore.

Natyrisht se të gjitha këto shkelje ligjore ndodhin si pasojë e keqpërdorimit të rëndë të detyrës zyrtare nga ana e zyrtarëve të prokurimit të institucioneve publike, të cilët në shumicën e rasteve janë të ndikuar politikisht. Kjo e bënë dukurinë e korrupsionit në procedurat e prokurimit publik, tërësisht të ndërlidhur me partitë politike. Për këtë shkak, lufta kundër korrupsionit mbetet plotësisht në vullnetin politik të subjekteve politike.

Nga ana tjetër me Rregulloren e Punës së OSHP-së, Kryetarit të OSHP-së i është dhënë mundësia “të vendosë në lidhje me përbërjen e Paneleve Shqyrtuese si dhe emërimin e anëtarëve të OSHP-së, në Panele Shqyrtuese, në pajtim me Nenin 23 të rregullores aktuale të punës”.

OSHP-j është organ kolegjal, ndaj emërimi i paneleve shqyrtuese do të duhej të ishte përgjegjësi e OSHP-së në tërësi e jo vetëm e Kryetarit të saj. Një qasje e tillë hap mundësinë e keqpërdorimit të detyrës zyrtare

nga ana e personit që ushtron këtë funksion, ndërsa përveç tjerash e zbehë transparencën e procesit të emërimit. Pra pozicioni i kryetarit të OSHP-së, duhet të jetë “I pari ndër të barabartët” dhe që vendimmarrja për të gjitha çështjet që janë në kompetencë të OSHP-së duke përfshirë edhe emërimin e paneleve shqyrtuese, të jetë kolegjiale e jo individuale.

Qeveria sipas propozimit të Ministrisë për financa vendos një listë të mallrave ose artikujve të përdorimit të përbashkët, prokurimi i të cilave i është caktuar Agjencisë Qendrore të Prokurimit.

Ekziston rreziku që përmes kësaj kompetence të AQP-së, të shfaqet mundësia që përmes zhvillimit të procedurave të prokurimit publik për mallrat dhe artikujt e caktuar qeveritar, të bëhet një lloj centralizimi i mundësisë së keqpërdorimit të këtyre procedurave, për qëllime të përfitimit të kundërligjshëm.

Rekomandojmë që në rishikimin e ardhshëm të Ligjit të Prokurimit Publik, të përfshihen edhe disa reforma organizative përkitazi me

organet administrative qendrore, në fushën e prokurimit publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, duhet të fuqizohet më tutje me kapacitetet e nevojshme profesionale dhe teknike si dhe me përgjegjësi të reja ligjore. Në këtë kontekst është e nevojshme të shqyrtohet mundësia e shkrirjes administrative dhe funksionale të KRPP-së dhe OSHP-së, në një mekanizëm të vetëm të mirë organizuar dhe strukturuar me qëllim të kryerjes së aktiviteteve monitoruese dhe shqyrtimit të ankesave nga operatorët ekonomik por edhe në shqyrtimet me vetë iniciativë, për rastet e dyshimit të shkeljes së procedurave të prokurimit publik. Një organ i tillë do të duhej të jetë në gjendje, që të ndëshkojë në mënyrë më të ashpër autoritetet kontraktuese për shkeljen e dispozitave të legjislacionit të prokurimit, por gjithashtu të fusë në listën e zezë operatorët ekonomik të cilët kryejnë shkelje të rënda. Kjo do të ndihmonte disiplinimin ligjor të aktorëve kryesorë në procedurat e prokurimit publik.

Nga ana tjetër për sa i takon opinionit publik, ekziston një perceptim i përgjithshëm se përpjekjet e organeve kompetente

për zbulimin, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e korrupsionit nuk janë të mjaftueshme për të penguar shtrirjen e mëtejshme të korrupsionit në shoqëri. Tendencat e rritjes së mëtejme të tij, të theksuara nga të gjitha raportet ndërkombëtare dhe vendore më së miri e provojnë një perceptim të tillë.

Andaj, është më se e domosdoshme fuqizimi i mëtejme i përpjekjeve nga ana e prokurorisë publike, pasi që te ky institucion në radhë të parë bie përgjegjësia e zbulimit dhe ndjekjes penale, të kryesve të veprave penale me natyrë korruptive.

Gjithashtu edhe performanca e deritanishme e misionit të sundimit të ligjit të Bashkimit Evropian EULEX, në luftimin e korrupsionit në Kosovë, nuk i arsyeton as për së afërmi pritjet e qytetarëve të Kosovës.

Arritja e sukseseve evidente të këtij misioni evropian në fushën e luftimit të korrupsionit në Kosovë ndërlidhet jo vetëm me justifikimin e vetvetes por edhe me besueshmërinë në aftësinë e Bashkimit Evropian, për të projektuar dhe realizuar me sukses misione ndërkombëtare në vendet e ndryshme.

Është i nevojshëm rishikimi i Ligjit mbi Agjencinë kundër Korrupsionit (AKK) dhe Kodit të Procedurës Penale, me qëllim të fuqizimit të mëtejme të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit. Ky institucion duhet të disponojë instrumentet e duhura ligjore, për të pasur mundësi të përballet fuqimisht me dukurinë e korrupsionit. AKK-ja duhet të jetë në gjendje të kryejë hetime penale nën mbikëqyrjen e prokurorit publik konform Kodit të Procedurës Penale.

Rrjedhimisht kjo do të rriste efikasitetin në hetimin e veprave penale me natyrë korruptive nga AKK-ja dhe prokuroria publike. Si rrjedhojë e kësaj në vend të kritikave të ndërsjella ndërmjet këtyre institucioneve për kallëzime penale jo profesionale apo për mos trajtimin e duhur të rasteve të procedurave nga AKK-ja në prokurori, do të fuqizohej bashkëpunimi ndërinstytucional si e vetmja mundësi për fuqizimin e përpjekjeve kundër korrupsionit. Kjo gjithashtu e bënë të mundshme adresimin e vërtetë të shkakut, për mos hetimin dhe mos ndjekjen e korrupsionit.

Nga ana tjetër aktivitetet në parandalimin e korrupsionit në procedurat e prokurimit publik përmes dhënies së udhëzimeve të detyrueshme për autoritetet kontraktuese, duhet të jenë përgjegjësi e Organit Shqyrtues të Prokurimit e jo e Agjencisë kundër Korrupsionit. Kjo nga fakti se OSHP-ja është organ i specializuar në fushën e prokurimit publik me përgjegjësi ekzekutive ndërsa AKK-ja, duhet të ruajë përgjegjësinë që në rast të dyshimit për vepër penale, t'i adresojë këto raste te prokurori publik për procedim penal të mëtutjeshëm e jo të ndërhyjë

paraprakisht, duke i paragjykuar ato.

Asnjë masë për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit nuk mund të ketë sukses, pa shprehjen dhe demonstrimin praktik të vullnetit politik të organeve shtetërore qeveritare dhe parlamentare si dhe të partive politike për zhvillimin e një lufte të vërtetë kundër korrupsionit. Kjo do të rikthente besimin e qytetarëve te institucionet si dhe do të forconte legjitimitetin dhe kredibilitetin e këtyre në raport me opinionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Ky Raport është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar si nga stafi i lëvizjes FOL por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Në këtë kontekst Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL, janë të publikuara në këtë uebfaqe: www.levizjafol.org.

Rreth Lëvizjes FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën

publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

Kontakto:

Rruga “Andrea Grop”,
Nr.35, 100000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Mob: +377 (0) 44 131 542
Ueb: levizjafol.org
E-mail: info@levizjafol.org

